

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.10.2025, ora 12:15 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Mirëdita të gjithëve. Të nderuar Këshilltarë, Kryetar i Bashkisë, mirë se erdhët në mbledhjen e muajit shtator. Para se të fillojmë, janë shpërndarë kartat për të gjithë antarët e këshillit, të cilat duhen vendosur nga ky moment dhe të hiqen kur të mbarojë mbledhja. Ju ftoj të gjithëve të vendosni kartat që të bëjmë apelin.

Enerieta Ferra – Zv. Kryetare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Bën apelin. Në sallë janë 38 Antarë të Këshillit Bashkiak.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Kalojmë tek pika e parë për miratimin e rendit të ditës.

Altin Mecja-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Kam diçka për të diskutuar. Pash procesverbalin, nuk ishin të pasqyruara të gjitha. Unë ju drejtova me disa pyetje kërkesë a sygjerime Kryetarit të Bashkisë dhe as nuk shava sepse nuk I përkas asaj shkolle Bolshevike komuniste

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Zoti Altin tek rendi I ditës tek pika e procesverbalit mund të thuash çfarë ke.

Erion Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Së pari kjo historia e shtimit të pikave te rendi I ditës pa njoftim duhet të marri fund. Keni futur tek të ndryshmet këtë shfuqizimin e vendimit nr 79. Jemi kthyer si puna e asaj lojës kalamajve dhe nuk besoj që një aset kaq I rëndësishëm siç është Elbasan Arena të futet në sekondë të fundit në rend dite, pa u diskutuar në komision. E dyta lidhur me procesverbalin ta kam sqaruar edhe tek pjesa e komunikimit në whats up si këshill. Ky procesverbal lidhur me 2 pikat e rendit të

kaluar për performancën dhe për etikën do përfundojnë në gjykatën administrative. Të dyja këto pika rishikojini sepse shkojnë në gjykatën administrative për pjesën procedurale dhe për ata që e kanë hartuar, janë kundravajtje penale.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika e parë e rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës.

Këshilli Bashkiak me 26 vota pro, 2 kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.
(E. Murataj; D. Madhi)

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Erion Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Nuk kalon me 25 vota

Enerieta Ferra – Zv.Kryetare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Nuk ka mundësi, vetëm ne jemi 28 në sallë, forca e PS

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Nuk ka mundësi mos ka ndonjë lapsus nga ana teknike.I keni futur të gjithë kartat?Kejsi e ke futur kartën sepse del pa votuar.

Kejsi Cakani-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

E kam futur kartën,mos ka ndonjë gabim Teknik.Unë votova pro

Erion Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Pse I detyron votën ti?

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

I detyroj ta lexojnë,është e pashprehur.Atëherë me 26 vota pro kalon rendi I ditës.

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.10.2025, ora 12:15 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Kalojmë tek pika 2 për miratimin e procesverbalit të muajit Gusht, vërejtja e z. Altin, do të shtosh gjë?

Altin Mecja-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Nuk ishte plotësuar gjithë diskutimi që kisha diskutuar, të paktën të kishte një rrumbullakosje jo aq letrare sa unë jam, po doja të bënte gjërat më kryesore. Unë kam vënë re që në procesverbale sa herë që kritikohet Kryetari i Bashkisë, ne e kemi me institucionin, nuk e kemi me Z. Llatja. Skam asgjë personale me atë përkundrazi, kur i drejtohem Kryetarit të Bashkisë i drejtohem institucionit. I thashë që nuk duhet të ndërhyjë Edi Rama në pushtetin vendor, mos i përsëris më, dhe puntorët e bashkisë nuk i heq dhe i ve Edi Rama. Unë mendoj që thashë një gjë të mirë, herë tjetër unë i dua të zbardhura, nëse janë të rëndësishme ose jo unë i marrë vetë, ska nevojë për të ruajtur njëri tjetrit neve. Do ti them edhe sekretariatit një gjë tjetër, që sa herë votoj unë do ta shkruani ashtu siç unë votoj me emër jo 32 pro apo kundër, e dua me emër, në disa raste se keni bërë sidomos në rastet sensitive si bëni me emra. Edhe abstenimet. Si kam borxh asnjërit, pse duhet të mbaj unë gjëra të establishmentit politik 34 vjeçar

Doris Madhi- Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Duke qenë se pak më parë bëra një thirrje për procedurë dhe nuk e pate durimin ta dëgjoje, thirrja e parë që po të bëj sot është ruaje durimin se mbledhja qenka shumë e gjatë dhe me shumë pika. E drejta e fjalës është e njëllajtë për të gjithë e nëse këtu ka nga ato që i mbyllet goja nuk është ky rasti, kështu që të jetë e para dhe e fundit kjo. Nga muaji korrik kualicioni bashkë fitojmë ishte pa një kryetar grupi. Në shkresat që janë depozituar në Këshillin Bashkiak në momentin kur është konstituuar grupi, juve ju është depozituar emër i kryetarit dhe i nënkryetarit të

grupit dhe pyetja ime është pse nuk lajmëroni nënkryetarin e grupit që të jetë prezent në mbledhjen e konferencës së kryetarëve, për atë kohë sa neve nuk kemi informacione për ndryshime që ndodhin në rendin e ditës apo dhe për pikat që futen në rendin e ditës. Faleminderit dhe më jep përgjigje.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Ka 2 institucione në këshill që funksionon, është kryesia e këshillit e cila përbëhet nga kryetari, dy zv.kryetarët dhe sekretari të cilët merren me materialet, përgatitjen e mbledhjes, siç I sjell unë dhe e gjithë bashkia dhe jua servirim në datat ,komisionet përkatëse dhe mbledhjet përkatëse. Kur kryesia e shikon të arsyeshme, neni 21 pika 2 vendos thirrjen e konferencës së kryetarëve të cilët në konferencën e kryetarëve përveç këtyre të 4-ve që thashë bëjnë pjesë dhe kryetarët e grupeve të këshillit. Gjithashtu kur e shikon të arsyeshme fton dhe Kryetarin e Bashkisë apo Nënkryetarët. Në rast konkret ne nuk kemi bërë asnjë shkelje sepse ne kemi mbledhur kryesinë

Doris Madhi- Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 6 neni 22 I rregullores të thotë që kryetarët e çdo grupi duhet të jenë prezent në përcaktimin e kalendarit dhe rendit të ditës, e kemi bërë dhe herë tjetër bashkë këtë debat.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Unë nuk kam asnjë shkelje sepse unë kam zbatuar këtë, të lutem. Unë jam bazuar tek rregullorja e funksionimit të Këshillit Bashkiak. Konferenca thirret kur bëhet një program, kur bëhet një kalendar ose kur konferenca e shikon të arsyeshme. E dyta lidhur me mungesën e kryetarit apo nënkryetarit këtu nuk është vendi, mund ta zgjidhni vet, e keni vet në dorë

Doris Madhi- Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Kalendari dhe rendi I ditës, ta përcakton rregullorja. Ke një shkresë ti aty dhe për atë kohë sa neve do zgjedhim kryetarin kto janë punët e tona. Në shkresë ti ke një nënkryetar që në momentin që mungon kryetari e zëvendëson. Thirrjen do ja drejtosh atij shiko procedurat e tua ti mos u merr me tonat.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Juve ju është dhënë hapsira gjithmonë sikur jeni kryetare grupi në momentin që ska qen kryetari

Doris Madhi- Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Unë nuk kam qenë në hartimin e rendit të ditës dhe kur na keni dërguar rendin e ditës dhe pastaj keni bërë edhe ndryshime, asnjë nga ne nuk ka ardhur në dijeni nga antarët e grupi bashkë fitojmë kështu që... këtë duhet të raportosh ti.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Zoti Altin ka dhe një zgjidhje në lidhje me procesverbalin dhe unë mendoj që duhet ta bëjmë që juve si grup duhet të sillni 1 person dhe 2 janë nga mazhoranca pra janë 3 Antarë Këshilli që firmosin procesverbalin me firmën e Kryetarit apo drejtuesit të seancës dhe Sekretarit të Këshillit. Ky procesverbal firmoset jo më vonë se 2 ditë nga zbardhja e saj.Kjo na shërben edhe në të ardhmen sepse përderisa ne marrim një vendim dhe themi ky vendim brenda 10 ditëve shpallet edhe presim që procesverbali të marri ok mbas 30 ditëve kur bëhet mbledhja e rradhës do të thotë që dhe kjo është një ngërç që mund të zgjidhet. Pra 2 antarë do zgjidhen nga mazhoranca dhe 1 nga ju për firmosjen e procesverbalit.

Bianka Çopja- Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Përshëndetje të gjithëve dhe një muaj të mbarë.Duke qenë se tek pika të ndryshme në shumicën e rasteve Kryetari I Bashkisë nuk denjon të qendrojë, më duhet të ngre një shqetësim madhor për qytetin tonë sepse sipas raportit të fundit të Agjensisë Kombëtare të Mjedisit, Elbasani ishte qyteti më I rrezikuar nga ndotja dhe ky nuk është më një perceptim I yni politik por është një fakt I dokumentuar dhe mendoj që ne të gjithë si këshill duhet të ndërmarrim hapat e duhura për të rregulluar këtë gjëndje ku jemi sepse nuk po flasim këtu për interesa personale por po flasim për ajrin që ne marrim frymë, për jetën e të gjithë qytetarëve ...Zoti Luti të lutem, duke qenë se nuk denjoni të rrini tek të ndryshmet më duhet ta maroj këtë që po them dhe kjo nuk është një çështje që duhet lënë për në fund të rendit të ditës . Është e mira që të gjithë duhet të bëjmë diçka dhe mbi të gjitha Kryetari jonë I Bashkisë duhet të marri masa që të çojë projektet e duhura në Ministrinë e Mjedisit që të paktën të merren parasysh, se të paktën mos të ngelin si historia e kunatit të Zotit Xhemal në fund që asnjë gjë nuk bëhet. E kam fjalën për Bashkinë Elbasan, a

jeni ju Kryetari I Bashkisë Elbasan? Për ndotjen e ajrit në Elbasan, për Agjensinë Kombëtare të Mjedisit e keni raportin të afishuar ku Elbasani është qyteti më I rrezikuar nga ndotja në Shqipëri. Nëse nuk e keni këtë informacion mund ta hapni ta lexoni. Ju mund të thoni për rendin e ditës por kjo është një çështje madhore dhe po flasim për jetën e qytetarëve dhe ajrin që ne thithim që minimalisht ju jeni aty për të marrë masa dhe për të bërë projektet e duhura aty ku duhet, jo thjesht për të bërë pastrime sa për foto dhe për të bërë vijëzime e për të futur 5 puntorë, bëhen foto e për ti publikuar në rrjete sociale.Duhet të bëjmë më të mirën për ajrin që thithim , për ujin, për tokat e për çdo gjë që na rrethon në qytet.Faleminderit!

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Nuk duhet të kishit folur jashtë rendit të ditës.Vazhdojmë me pikën 3

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.10.2025, ora 12:15 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 3 e rendit të ditës

3. Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi I Bashkisë për Muajin Gusht 2025

Këshilli Bashkiak me 37 vota pro,- kundër, 2 abstenim, miraton sa më sipër.

(D.Madhi;E.Murataj)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.10.2025, ora 12:15 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 3.1 e rendit të ditës

3.1 Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi I kushtëzuar për Muajin Gusht 2025

Këshilli Bashkiak me 37 vota pro,- kundër, 2 abstenim, miraton sa më sipër.

(D.Madhi;E.Murataj)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Zamir Muzhaqi – Zv. Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Për proçedurë, kemi miratuar vetëm pikën 1 të rendit të ditës dhe kaluam tek pika 3

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Të na falni, kemi kaluar pa dashje tek pika 3 pa miratuar pikën 2 proçesverbalin. E votojmë dhe njëherë pikën 2.

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.10.2025, ora 12:15 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 2 e rendit të ditës

2. Miratimi i proçesverbalit të muajit Gusht datë 03.09.2025

Këshilli Bashkiak me 27 vota pro, 5 kundër, 6 abstenim, miraton sa më sipër.

(M. Kaçuli; A. Marku; A. Meçja; E. Murataj; Z. Muzhaqi)

(B. Çopja; A. Domni; E. Isaj; A. Kana; D. Madhi; R. Mita)

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.10.2025, ora 12:15 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 4 e rendit të ditës

4. Për dhënien në përdorim të fondit pyjor publik antena të telefonisë celulare.

Shefqet Bullari- Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Bëhet fjalë për një kompani celulare që do të vendosi dy antena. kontrata do të lidhet ndërmjet Bashkisë dhe operatorëve celularë. Është bërë kërkesa nga operatori celular përkatës, është marrë leja mjedisore nga ministria përkatëse, nuk ka ndotje në mjedis, nuk ka probleme me pyjet në infrastrukturën rrugore. Antena e parë vendoset në tokë inproduktive, çmimet janë sipas vendimit 559 të qeverisë janë çmime fikse. Antena e parë ka 205 m² dhe çmimi që përfiton Bashkia 106.250 lekë ndërsa antena e dytë në Zavalinë shtrihet në pyll ka 220 m² dhe çmimi varion në 220.000 lekë. Kontrata lidhet për 9 vjet, është një rinovim i zakonshëm, sipërfaqe të vogla pyjore të cilat Bashkia ka interes të marrë taksat përkatëse dhe tarifat, mendoj që të votohet sepse është rinovim kontrate.

Aurora Domni- Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Për 1 vit vihen antenat, nuk diskutohet por shqyr që vihen andej nga malet që përfiton dhe bashkia, gjë e mirë është por a mund ti heqim nga pallatet se kemi parë shumë antena? Kjo është kërkesë për të mirën e të gjithëve. Antenat e shumta brenda qytetit sipër tarracave, a është në të ardhmen ndonjë projekt i juaji ti zhvendosi të paktën më tutje tek zonat me pyje? Faleminderit!

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Gabimisht është fshirë votimi për ndihmën ekonomike pika 3 dhe 3.1, ju ftoj ta votoni edhe njëherë.

Zbardhja e votave për ndihmën ekonomike është në pikën 3 dhe 3.1.


Këshilli Bashkiak me 32 vota pro, 2 kundër, 2 abstenim, miraton sa më sipër.

(E.Murataj;A.Marku)

(M.Kaçuli;D.Madhi)


Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.10.2025, ora 12:15 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 5 e rendit të ditës

5. Për miratimin e shpalljes së zonave prioritare të zhvillimit në territorin e Bashkisë Elbasan.

Astrit-Përfaqësues I Administratës

Bazuar në urdhrin e Kryetarit të Bashkisë për ngritjen e grupit të punës për shpalljen e zonave prioritare të zhvillimit mbështetur në ligjin 20/2025 për paketën e maleve. Grupi I punës ka kryer analizën e gjithë të dhënave përkatëse social ekonomike për potencialin që ofrojnë këto zona dhe ka arritur në përfundimin që të shpallë 4 zona prioritare për Bashkinë Elbasan të cilat janë; Njësia Administrative

Gjinar, Shushicë, Tregan dhe Funar. Këto zona siç njihen edhe nga ne kanë potencial për zhvillimin ekonomik të zonës dhe ka praninë e poseduesve jo pronarë faktikë. Grupi punës për mbarrëvajtjen e punës ka kryer konsultimin publik me banorët e zonës, ka mbajtur procesverbalet me banorët posedues faktik të atyre pronave dhe në përfundim ka arritur që këto zona ti shpallë si zona prioritare zhvillimi

Gledian Llatja-Kryetar i Bashkisë Elbasan

Në fakt është bërë një punë e mirë nga grupi I punës që është marrë me evidentimin e zonave të cilat kanë prioritet, duhet sqaruar që është një ligj, ligji paketa e maleve. Është një paketë e cila vjen në ndihmë banorëve të zonave malore sidomos për zhvillimin e agroturizmit dhe të bizneseve të tjera, ekonomive të tjera ndihmëse në zonat rurale. Çështja kryesore ka zgjidhur problematikën që shpesh herë kanë zonat malore me çertifikatat e pronësisë ku një pjesë e tyre ashtu siç e dimë dhe një pjesë e jona e madhe në fakt që janë në terren e dinë që një pjesë e maleve e zonave malore nuk kanë shkuar sipas amtp-ve por kanë shkuar tek tokat e të parëve të tyre dhe kjo nuk e ka bërë të mundur marrjen e titullit të pronësisë, nuk ka patur një akt ligjor të kohës dhe automatikisht ato kanë vazhduar e kanë poseduar gjatë gjithë kësaj kohe tokën e tyre në zonat malore dhe nuk kanë mundur dot të marrin çertifikatë pronësie për të zhvilluar pjesën e vet të një ekonomie ndihmëse në shërbim të agroturizmit dhe të zhvillimit të zonave malore. Mbasi është bërë prioriteti I përcaktuar nga ligji pra për zonat të cilët preken nga kjo paketë ose në kuptim të këtij ligji, janë përcaktuar 4 zona, në fakt kanë qenë të hapura aplikimet në sistemin e-albania për të gjithë ato që kanë dashur të aplikojnë dhe kanë patur interes të aplikojnë për paketën e maleve. Ka patur një numër të madh të interesuarish të cilët kanë dashur të aplikojnë për këtë paketë, jo vetëm për masat mbështetëse por edhe për sistemin ligjor që I është dhënë çështjes së pronësisë së tokës. Nga grupi I punës është bërë analizimi në terren, kanë qenë pjesë e grupit të punës dhe administratorët dhe Kryepjeqetë, kemi patur takime të vazhdueshme për informimin e banorëve por edhe për të marrë mendim mbi zhvillimin që jep kjo paketë për të vazhduar më tej pastaj me procedurat e tjera. Ky është një akt që ne në thelb vendosim një zonë prioritare ashtu siç e kërkon dhe ligji pra Njësitë Administrative prioritare. Jo e gjithë Njësia Administrative domosdoshmërisht ka interes, kryesisht do ecet aty ku ka interes nga banorët. Ligji parashikon dhe aktet nënligjore që mbas çdo rasti miratohet një procedurë në

Këshillin Bashkiak që pastaj ato vazhdojnë me pjesën e marrjes së lejes së ndërtimit pa patur titullin e pronësisë së tokës. Mbasi kanë mbaruar investimet dhe gjithçka tjetër futen në pjesën e marrjes së certifikatës së pronësisë. Kto janë disa nga parimet bazë të kësaj pakete dhe të këtij ligji. Është bërë kjo punë deri tani pra është bërë evidentimi i ktyre zonave për ti dhënë një potencial. Janë marrë zonat të cilat kanë patur një interes më të madh nga banorët por edhe zonat të cilat në thelb kanë prioritet turizmin malor. Ka patur dhe ka potenciale të tjera Elbasani, siç është dhe Labinoti Mal apo pjesa malore apo kodrinore e Labinotit Fushë apo Graceni që është zonë malore dhe ajo por që në thelb kërkesat kanë qenë më të ulta për zhvillimin e këtij aktiviteti ekonomik dhe prandaj është arritur në konkluzionin që janë 4 Njësi Administrative. Në rast se do të ketë një interes të shtuar patjetër që mund të futet dhe ajo si prioritet. Kjo zona prioritare do ti çohet Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor i cili do të bëjë shpalljet përkatëse, të gjithë qytetarët që kanë interes për ta vazhduar prioritetin do të vazhdojnë procedurat ligjore pra kjo i hap rrugën ligjore të gjithëve atyre që kanë aplikuar për të vazhduar më procedurën për paketën e maleve. Faleminderit!

Erjon Murataj-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Një ndërhyrje për këtë pjesë, në fakt është mirë që ka nisma të tilla shtetërore për të nxitur investimet në trojet e të parëve. Por një nga zonat prioritare që është vënë këtu është dhe Njësia Tregan, e për mos na bërë budallenj Njësia Tregan nuk është thjesht një zonë e cila duhet zhvilluar, është e zhvilluar. Madje të lidhur me interesa brenda dhe jashtë kësaj sale ka njerëz që kanë investuar miliarda duke përvetsuar tokë që se kanë patur të vetën atje, janë dhe ujrat termale. Me të drejtë juve thoni që jo çdo sipërfaqe e Njesisë Administrative do përfitojë nga kjo. Në fakt e ndan një fije shumë e hollë abuzimin nga dobia e qytetarëve. Atje në Tregan ka plot banorë të cilët janë autoktonë të cilët vuajnë për të marrë leje ndërtimi qoftë edhe për të hapur një dritare ndërkohë që sipërfaqet shtet në Tregan prej vitesh në memorien time historike që prej vitit 2001-2002 kanë disa studime dhe shërnaja e madhe që është bërë në Elbasan me të vjetrit e me të mëdhenjtë e politikës ka qenë brenda apo jashtë vijës së verdhë në atë kohë, sot ka dalë kjo terminologjia e re që është si zonë prioritare. Unë mendoj që përpara se ti shkojmë përkrah këtyre aplikimeve për paketën e maleve nga njerëz që ndoshta kanë uri të madhe për të gllabëruar toka qofshin ato shtetërore qofshin private, ne do të duhet që të kanalizojmë të gjitha aplikimet në raport me banorët e Treganit. Kjo do të ishte dhe

dobia, do të ishte dhe hapi I parë që një politikë sociale e majtë do ti afroheshe dhe do ti mbështeste ata, që do të thotë zona si Tregani sepse nuk po flas për Funarin apo për Gjinarin. Zona si Tregani duhen parë në një optikë tjetër duke qenë se burimet termale atje në fakt edhe pse janë përvetsuar atje në mënyrë makabër nga individë, janë pasuri shtetërore dhe nuk tjetërsohen dot.

Altin Mecja-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Kam frikë se kjo e gjitha do dali natë ahengu në fakt. Ktë paketën e maleve unë e shof si marrje e tokave katundarëve, unë kështu e shikoj, rreziku I përvetsimit të tokave publike mund të jetë nga njerëz që vijnë jo nga zona se do ndodhi si puna e asaj që ndodhi në Theth, se nuk ishte histori bujtinash ajo dhe histori kasollesh. Është histori lojtarësh të mëdhenj, majtës dhe djathës për të zënë pyjet e njerëzve atje dhe tokat. Dua ti bëj një pyetje këtu juristëve, ne pyjet nuk I kemi me çertifikata pronësie po I kemi pylli I filanit...

Eva Bica- Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Ligji parashikon që ato të cilët aplikojnë duhet të jenë posedues të pronave shtet dhe jo të pronave private. Transparencë se statusi në juridik në ASHK është I thjeshtë

Zamir Muzhaqi – Zv.Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Të lutem do doja ti drejtoja 2 pyetje Kryetarit të Bashkisë për këtë pikë pasi dhe në ligjin e ri që u emërua paketa e maleve nuk e njohim mirë. Pyetja 1 -Përjashtohen nga ky ligj zonat e tjera të cilat nuk janë prioritet? Pra grupi punës ka cilësuar 4 zona të tilla, qytetarët e zonave të tjera përjashtohen nga ky ligj? Pyetja 2-Përveç faktit që bashkia e ka patur detyrim ligjor që të shpalli zonat prioritare, a ka mundësi në procedurë të tjera pas shpalljes së zonave, bashkia pra a ka mundësi bashkia që të jetë pjesë e paketës së maleve apo do jetë totalisht pjesë e pushtetit qendror? Këto 2 pyetje kisha.

Gledian Llatja-Kryetar i Bashkisë Elbasan

Zonat prioritare këtë po bëjnë sot, po përcaktojnë zonat prioritare në bazë të një analize që është bërë totale pra është bërë analiza nga stafi, është ngrit një grup pune që ka bërë punë prej 2 muaj për këtë gjë dhe njësitë e tjera nuk janë zona prioritare. Ligji kërkon zona prioritare që të ecet dhe në moment që ne shohim që

ka një zonë tjetër prioritare do rishikohet sipas ligjit dhe do vihet në Këshillin Bashkiak të kërkohej futja në listën e prioriteteve. Ishte I qartë besoj? Nuk futen tek lista prioritare njësitë e tjera dmth qyteti bashkë me 8 njësitë e tjera administrative nuk futen në listë prioritare. Bëhen procedurat në bashki dhe në e-albania, meren një sërë dokumentash nga subjekti, vazhdon subjekti bën aplikimin dhe ne e miratojmë rast pas rasti në Këshill Bashkiak, se ja japim pjesën e të drejtës për të zhvilluar pra kalon një listë në Këshillin Bashkiak çdo herë për aplikantët

Artan Kana-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Përshëndetje të gjithëve. Në këtë pikë kisha diçka për të shtuar dhe për të bërë një pyetje për kryetarin. Tek paketa e maleve sipas punës që ka bërë bashkia në bazë të ligjit dhe kërkesave të qeverisë për zonat prioritare kisha një pyetje- A ka bashkia kapacitet dhe financa të mjaftueshme për tju përgjigjur kërkesave të investitorëve të mundshëm përfitues të paketës së maleve, për rrugë dhe për infrastrukturë ndihmëse të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve ekonomik të tyre? Kisha dhe një koment pas kësaj pyetje që jo gjithmonë qëllimi I mirë justifikon mjetin. Qëllimi I mirë është ajo që qeveria ka menduar të bëjë paketën e maleve ndërsa mjetet janë ato të cilat rrugët dhe mënyra se si do të implementohet kjo gjë në terren dhe tek pronat e qytetarëve dhe siç kemi parë në shumë inisiativa të tjera të qeverisë siç ishte ajo për turizmin kur në një bum turistik që për mua ishte shumë I gabuar, Shqipëria në këtë vit dështoi dhe vitin tjetër mos e dhëntë Zoti do dështojë edhe më keq. Ne I ftojmë njerëzit të vijnë në një vend ku nuk kemi kapacitete për infrastrukturën, për shërbimet dhe për shërbimet hoteliere.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Në rregull u kuptua, edhe pyetje dhe diskutime kalove 5 minuta, po I përsërit.

Artan Kana-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Sepse ju vetë pranoni tek ky relacion që na keni dhënë që nuk është bërë azhurnimi I pronave, infrastruktura nuk është në nivelin që kërkohej dhe duke qenë se azhurnimi I pronave nuk është bërë akoma kjo është e kuptueshme si do vejë. Kto të cilët kanë ndërtuar pa leje që kanë ndërtuar ato investitorët të cilët I kanë bërë tashmë investimet, do futen te kjo paketë dhe do ti legalizojnë shumë lehtë ato.

Banorët të cilët ne e dimë që nuk kanë mundësi të investojnë do ngelen po me gisht në gojë dhe do na shkatërrohen edhe kto pak resurse që kemi në mënyrën e gabuar prandaj të jeni të vëmendshëm dhe mos u nxitoni me një gjë që në dukje duket e mirë por ne nuk jemi gati për të shpërthyer edhe me paketën e maleve siç u shpërthyen ndërtimet në jug. I shikoni përditë dhe jeni koshient se çfarë po ndodh atje.Faleminderit!

Gledian Llatja-Kryetar i Bashkisë Elbasan

Kjo është një paketë e mirë,unë e kuptoj gjith pjesën e asaj dëshirës që keni që mos ec përpara kjo gjë por është një paketë e mirë që I vjen në ndihmë qytetarëve,atyre ndaj të cilëve sot e kanë përdorur tokën.Besoj një pjesë e madhe në fshat sidomos te zonat malore që ne e kemi pas njoftur si tokë babë , kanë shkuar tek toka e të parëve pra skanë përdor 7501 dhe automatikisht nuk kanë marrë çertifikata pronësie sot e kësaj dite apo kanë marrë me 7501 në një zonë tjetër dhe kanë shkuar aty ku e kanë patur tokën e vet pra kanë shkëmbyer tokat me njëri tjetrin.Ato që sot kanë dëshirë apo interes që sot të marrin investime për zhvillim, jo për të marrë tokën.Nuk po flitet që ti të marrësh tokën të cilën e ke mbjellë prej 40 vjetësh me ullinj apo e ke patur tokën tënde dhe do thjesht të bësh letrat e pronësisë.Kjo është për ato që kërkojnë ta zhvillojnë një cikël tjetër ekonomik dhe për ktë cikël po flasim ekonomik.Ato të cilët e kanë patur tokën e vet dhe nuk po flasim as për investitorë të mëdhenj apo të vegjël, ato banorë toke të cilët e kanë patur tokën e vet dhe duan ta zhvillojnë mund të aplikojnë tek paketa e maleve dhe I hapet një dritare e re për zhvillimin e pronës së tyre dhe të ekonomisë së tyre.Bashkia e Elbasanit ka buxhetimin me pjesmarrje ashtu siç ju e dini që fillojmë tashmë dhe infrastruktura rrugore patjetër që bëhet pas buxhetimit me pjesmarrje.Ka ardhur në shtim gjatë gjithë kohës pjesa e investimeve sidomos në zonat rurale,kuptohet kemi problematika shumë në infrastrukturë, do të përpiqemi ti qëndrojmë afër të gjithë banorëve dhe prioriteti kryesor patjetër që janë fshatrat kryesorë pastaj më mbrapa shifet tek pjesa e zonave të tjera.Faleminderit!

Artan Kana-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Nuk mora përgjigje shteruese për pyetjen që bëra dhe ndoshta ngaqë e zgjata pak mos nuk e mbajte mend.A kemi kapacitete si Bashki që ti përgjigjemi nevojave infrastrukturore që do të lindin me ...nëse nuk I keni a po merrni hapat e duhur që në momentin që do të kemi aplikime do të kemi dhe interesin e qytetarëve, Bashkia

të jetë gati të investojë dhe mos presim të investojnë qytetarët, të na vijë dhe ai bumi turistik që ne mendojmë dhe të gjendemi para faktit që nuk ka rrugë nuk ka shërbime dhe zhgënjejnë turistët.

Gledian Llatja-Kryetar i Bashkisë Elbasan

Atë po të shpjegoja që është fazë tjetër e investimeve, vjen tek buxhetimi me pjesmarrje tek planet buxhetore. Planet buxhetore të gjithë I kemi ktu dhe sot miratojmë një pjesë të planit buxhetor afatmesëm kështu që I ke këtu ato të gjitha. Nuk është se ke një kapacitet, duhen kapacitete. Kapacitet ne I dimë sa janë, I ke të shkruajtura në letër, ato që do bëjmë do shofim zonat prioritare, bëhet buxhetimi me pjesmarrje, miratohet në këshill investimet dhe kto janë.

Eva Bica- Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Meqë këtu u fol për problemet e pronësisë të cilat I takojnë ekskluzivisht banorëve të zonës thatë që keni bërë edhe një dëgjësë publike. Pse nuk janë procesverbalet e dëgjësës publike pjesë e kësaj dosje që na vjen sot këtu? Ta dimë dhe ne çfarë mendojnë ato personat që jetojnë në zonë, sigurisht pa tejkaluar kompetencat e qeverisë Shqiptare me paketën e maleve.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Ok drejtorja përkatëse mund ti vendosi në dispozicion.

Astrit-Përfaqësues I Administratës

Procesverbalet e mbledhjeve dhe konsultimeve publike janë publikuar në faqen e Bashkisë dhe kanë qenë dhe pjesë e dosjes.

Erjon Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Një ndërhyrje të vogël

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Zoti Murataj për të njëjten çështje jo 2 herë

Erjon Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Pyetja është e thjeshtë, juve për kto prona që është shfaqur interesi për investim, informacion tekniko ligjor mbi statusin e pronës që ky zotëria e posedon

qoftë me një objekt mbas ortofotos po themi të 2015 që vërteton që ka vite që e posedon ose qoftë vërtetim nga komuna që personi që aplikon te kjo toka shtet që mund të jetë dhe me pronar atje, është prej kohësh posedues ose zhvillues I asaj prone,keni?

Astrit-Përfaqësues I Administratës

Siç e tha dhe Kryetari I Bashkisë tani jemi në fazën e parë për miratimin e zonave prioritare, pasi dokumentacioni përkatës ti niset Ministrit së Shtetit për Pushtetin Vendor dhe të dalë VKM-ja përkatëse për miratimin e këtyre zonave.Do hapet portali online për depozitimin e kërkesave nga poseduesit faktik siç është faza e dytë për verifikimin e gjithë dokumentacioneve që do sjellin dhe kjo për të vërtetuar lidhjen me pronën posedues jo pronar faktik.Do sjellin një sërë dokumentash siç është vërtetimi nga njësia administrative,deklaratë noteriale, ortofoto vit pas viti, deklarata nga banorët rrethues.Për kto 4 zona ka qenë një portal online ku të gjithë banorët kanë shprehur interesin e tyre.Kjo ka qenë si indicie për shpalljen e këtyre zonave.Në Gjinar kemi patur më shumë se 60 aplikime, Funar po ashtu, në Tregan 20 aplikime dhe Shushicë 25 aplikime.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Hapim votimin për pikën 5.

Këshilli Bashkiak me 28 vota pro,3 kundër, 5 abstenim, miraton sa më sipër.

(M.Kaçuli;D.Madhi;E.Murataj)

(B.Çopja;E.Isaj;A.Kana;A.Meçja;Z.Muzhaqi)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.10.2025, ora 12:15 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 6 e rendit të ditës

6. Për një shtesë të numrit të punonjësve operacional në Drejtorinë e Shërbimit të Mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.

Shëfqet Bullari-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Ne si Këshill Bashkiak kemi miratuar në fund të vitit 2024 numrin maksimal të punonjësve të administratës dhe drejtorisë mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit I kemi miratuar 31 veta. Në bazë të ligjit të ri 152/2025 për këtë qëllim është një normativë që për 1500-2000 banorë të ketë një zjarrfikës. Ne gjithsej kemi 10 të tillë dhe mbi bazën e numrit të popullsisë që kemi si bashki që kemi 217.000 banorë duhet me domosdo që ta shtojmë këtë numër me 10 punonjës të tjerë dhe kjo argumentohet e para që të rrijë brenda standartit të ligjit që kërkon këtë raport me numrin e popullsisë. E dyta bashkia ka në plan të shtojë flotën e zjarrfikësve me 2 mjete të tjera të cilat kërkojnë edhe kto një numër punonjësish të caktuar për të shërbyer. E treta dy tre vitet e fundit ka një numër të shtimit të rastet të zjarreve ku del e domosdoshme bashkia të përqendrohet më shumë në këtë aspekt për të parandaluar dhe për ti bërë të mundur sa më pak dëme nga zjarret. Të treja kto argumenta duhet argumentuar për të shtuar këtë numër të kësaj drejtorie. Është domosdoshmëri për të arritur standartet ligjore megjithëse përsëri me gjithë shtesën që bëjmë përsëri ne jemi larg standarteve që kërkon ligji 152/2025.

Bianka Çopja- Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Ktë pikë e diskutuam edhe tek mbledhja e komisioneve dhe aty ja thashë dhe personit përgjegjës që nuk është një shtesë e zakonshme që ndodhi pikërisht në këtë

moment por pyetja ime është nëse realisht është e nevojshme shtimi I numrit të punonjësve? Ajo që kam konstatuar është që problemi I shërbimit tonë zjarrfikës në Elbasan, në fakt nuk është ky numri I punonjësve por janë mjetet jo funksionale që kanë, kushtet e punës që kanë dhe uniforma e çdo gjë tjetër. Dhe ajo që është më e tmerrshme tek shërbimi jonë zjarrfikës është që shpesh herë përdoren jashtë punës së tyre të zakonshme sepse jo më larg se zjarret e verës kur në Gramsh duhej një forcë e shtuar e shërbimit tonë zjarrfikës, çuditërisht zjarrfikësit tanë ishin duke pastruar markatën, duke bërë një punë që nuk I takon por thjesht për tu fotografuar dhe për të qenë në faqen zyrtare të Bashkisë, duke bërë një punë që janë aty për të fikur zjarrin, për të siguruar jetën e qytetarëve. Është e mira që mbi të gjitha ne duhet të mendojmë që ti rregullojmë kushtet këtyre punonjësve, ti japim mjete funksionale dhe pastaj të mendojmë për shtimin e numrit të punonjësve që në fakt janë thjesht persona që duhen aty nga ana partiake sesa nga ana e nevojës së qytetit. E mira është që duhet ti shikoni mirë kur I sillni të tilla vendime në Këshillin Bashkiak.

Erjon Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Vet fakti që një intelektual dhe njeriu me eksperiencë si Shefqeti po I dridhej zëri kur po raportonte këtë gjënë flet qartë që është emërim politik I 10 vetëve. Në fakt për ti vazhduar llogjikës Biankës MZSH nuk e ka problemin tek stafi në fakt e ka prej vitesh tek drejtimi dhe jo thjesht drejtimi I drejtuesit të ri po I klanit kulisave që është mbledhur atje I cili është një klan fallsifikatorësh sepse sot ju keni sjellë këtu atë që unë kam 2 vjet që ulëras oficerin e parandalimit. Elbasani ka 4 vjet pa officer parandalimi. Drejtoria e zjarrfikses e lëshon certifikatën e sigurisë ndaj zjarrit ndërkohë që ai djali që është atje shef sektori shkon I bën të gjitha, edhe turnin kur bie zjarri, edhe oficerin e parandalimit, bën edhe shkruetin e certifikatës. Për hir të së vërtetës analfabetizmi që e karakterizon shërbimin e MZSH-së në Elbasan është për të ardhur keq. Përpara se të emëroni njerëz politik, në nderin e kësaj Bashkie do të ishte respektimi I atyre nënpunësve që kanë luftuar me flakët. Do të ishte grantimi jo I 10 vendeve të punës me nga 60.000 lekë pagë që bëjnë rreth 72 milion lekë në vit por do të ishte paisja e atij personeli, do të ishte që mos ishte turp të shkonin të kërkonin nga 10 litra naftë nëpër karburante, do të ishte të mos I merrnin certifikatat me pilaf e qofte dhe më kryesorja do të ishte një institucioni operacional 24 orësh të mos trajtohej si puntorët e ASHPR-së të cilët përdoren dhe për dekor tha kolegja. Përpara se ju të sillni këto të 10-të, ai shërbim

zjarrfikës ka të drejtë për një testim sepse atje brenda ke drejtues zjarresh që janë 110 kg që I kanë shërbyer ps dhe pd dhe sot nga kolegët e vet janë me çështje në prokurori.

Gledian Llatja-Kryetar i Bashkisë Elbasan

Se vë në dyshim që dikush munda ta bëj më mirë sesa profesionistët punës se kush flet për punën e tjetrit dalin te pjesa që e bëjnë më mirë sesa tjetri por ka një strukturë aty që është drejtues dhe ka një strukturë që ka ardh prej kohësh dhe ajo që kërkohet sot në Këshill Bashkiak është që ne ktyre zjaërrfikësve tonë që I kemi të palodhur, që na janë gjendur gjatë gjithë kohës, edhe në shërbim të qytetit, shkollave, kopshteve, qytetarëve, të palodhur, orar pa orar, të kenë një gadishmëri më të mirë. Po meren edhe 2 mjete të reja zjarrfikse të cilat janë në procedura. Po shihet mundësia që vitin tjetër të rregullojmë ato ambjente që kemi tek zjarrfikset, patjetër nuk kemi pushuar së kërkuari projekte. Zjarrfikset tona janë funksionale të gjitha. Nuk kanë patur asnjëherë probleme përveç njëherë kur ra zjarri në verë që ka patur një problem boti prej 3 ditësh, pjesa tjetër që u zëvendësua menjëherë. Pjesa tjetër e gjithë zjarrfikseve ka qenë në efikasitet të plotë gjatë të gjith vitit e vazhdon të jetë me efikasitet të plotë. Kuptohet mjetet janë të amortizuara, kemi bërë investime të vazhdueshme për pjesën e mjeteve ashtu siç po blejmë 2 mjete të tjera duhen vitin tjetër të blejmë përsëri, të shohim mundësinë e shtimit të flotës së makinave me mjetet e reja moderne dhe me shkumë dhe sipas problematikave që kemi patur në terren ku njëri nga më të vështirit ka qenë në fushën e Metalurgjisë edhe në landfillin e mbetjeve ku gjithë zjarrfikset tona sëbashku me zjarrfikset e rretheve të tjera kan qenë në gadishmëri. Ashti siç edhe ne I kemi qëndruar pranë të gjitha zjarrfikseve të bashkive të tjera ashtu edhe ato na kanë qëndruar pranë. Ashtu siç shërbimet publike I kanë qëndruar pranë zjarrfikses bashkë me vullnetarët, bashkë me strukturat përkatëse patjetër që edhe zjarrfikset kanë bërë punë të tjera për komunitetin siç kan qen trajnimi I shkollave, kanë bërë ndihmë për qytetin që dhe ato që patjetër janë aty dhe kanë kapacitete dhe forcën që ndihmojnë komunitetin kurdo që kanë nevojë. Unë e shoh shumë të domosdoshme shtimin e një numri prej 10 zjarrfiksisht të rinj sepse numri që përcakton që duhet të jenë nën një moshë të caktuar në mos gaboj 30 vjeç pra të gjithë zjarrfiksit duhet të jenë nën 30 vjeç ka një problematikë edhe me zjarrfiksit sepse janë eksperiencia e qytetit përse I përket zjarrfikësve dhe nuk mund ti nxjerrësh në rrugë. Është e domosdoshme që dhe kto zjarrfikës të rinj që do merren duhet të trajnohen dhe të

jenë gati për sezonin e verës prandaj futet ky material sot, prandaj është futur pa pjesë buxheti sepse nuk do mund të merren të gjithë menjëherë por do merren brenda vitit, brenda muajit dhjetor, mbas shpalljeve mbas procedurave sepse vetëm procedura e shpalljes dhe verifikimi që I bëjnë testin fizik testin e personalitetit e gjithë gjërat e tjera kërkon kohën e vet që minimalisht është 45 ditë dhe vitin tjetër besoj në dhjetor a në janar të gjitha këto struktura do të jenë efikase do të trajnohen që të jenë gati për sezonin e zjarreve. Unë do ju bëja thirrje që ta mbështesim strukturën tonë të zjarrfikseve, është një strukturë efikase, e mirë por patjetër ka nevojë gjithmonë për përmirsim siçdo gjë tjetër prandaj duhet ti qëndrojmë pranë dhe ta miratojmë këtë mundësi që edhe zjarrfikset të kenë një staf të shtuar dhe të përshtatet patjetër edhe me ligjin. Qëllimi jonë është që të shohim edhe mundësinë për të hapur edhe një pikë tjetër pra një stacion në varësi të stacionit kryesor të zjarrfikseve në zonën industriale ku të ketë afër Bradasheshin, Paprin, Gracenin, Funarin por kryesisht edhe zonën industriale që ka dhe ajo një rrezikshëri të shtuar për shkak të funksioneve të biznesit që janë aty. Shpresojmë shumë që vitin tjetër të kemi dhe 2 mjete të reja, të kemi marrveshje me Ministrinë e Mbrojtjes për të pasuruar flotën tonë të makinave por patjetër që janë të domosdoshme edhe shtimi I numrit të punonjësve të zjarrfikseve. Kjo është vetëm faza e parë besoj se vitin tjetër do vijmë sërish me një shtim numri punonjësish pikërisht për të arritur standartin ligjor qërkohet nga ligji për emergjencat civile. Faleminderit!

Artan Kana-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Dua që ti falenderoj të gjithë punonjësit e MZSH-së për sakrificën me mjete rrethanore që rrezikojnë jetën e tyre për përballimin e situatave të rënduara të zjarreve që patëm sidomos këtë vit. Shtimi I ktyre punonjësve dhe mjeteve duhet të jetë diçka e vazhdueshme nga ana e bashkisë dhe gjithë strukturave shtetërore në këtë vend. Për ta bërë lidhjen edhe me atë të paketës së maleve ja pra sesi ju ndihmon edhe ajo që ju sygjerova që bashkia duhet të ndërhyjë në infrastrukturë sepse siç pamë nga raportimet e mediave zjarrfiksit nuk kishin mundësi të aksesonin përmes rrugëve që duhet të ketë nëpër pyje, se këto I mbeten ekspertëve që duhen hapur nga bashkia që në raste zjarresh mos presim të bjeri zjarri dhe pastaj të vrasim mendjen si do të shkojmë atje. Të bëhet edhe ky plan për një infrastrukturë edhe në raste zjarri dhe ti pajisni zjarrfiksit me mjetet moderne apo armët e duhura për të luftuar me zjarret. Jo thjesht të mbetemi tek ajo që ju kam thënë tek çdo shtesë që kemi në organikën e bashkisë, të shtojmë pafund

njerëz.Unë jam dakort të shtojmë por të shtojmë ata të cilët na duhen si zjarrfikësit në fjalë dhe unë jam dakort dhe të heqim ata të cilët marin rrogën dhe firmosin në fund të muajit në bashki.Faleminderit!


Këshilli Bashkiak me 31 vota pro,1 kundër, 7 abstenim, miraton sa më sipër.

(E.Murataj)

(Y.Balliu;B.Çopja;E.Isaj;M.Kaçuli;D.Madhi;A.Marku;A.Shtylla)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.10.2025, ora 12:15 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 7 e rendit të ditës

7. Miratimin për transferimin e automjetit “Autoveturë ID.7 PRO 210 KW Targa AB802VF shasia LFVVA9EA0R5353386, nga Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale në Agjencinë e Shërbimeve Publike Urbane.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Të treja pikat janë njësoj, ja transferojnë makinat njëri tjetrit, edhe në komision nuk pati ndonjë gjë

Këshilli Bashkiak me 30 vota pro, 2 kundër, 3 abstenim, miraton sa më sipër.

(E. Murataj; D. Madhi)

(B. Çopja; A. Shtylla; A. Kana)

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.10.2025, ora 12:15 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 8 e rendit të ditës

8. Miratimin për transferimin e automjeteve nga ASHPR në Agjencinë e Mbikqyrjes dhe Kontrollit.


Këshilli Bashkiak me 29 vota pro, 3 kundër, 1 abstenim, miraton sa më sipër.

(E. Murataj; D. Madhi; A. Marku)

(A. Shtylla)


Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.10.2025, ora 12:15 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 9 e rendit të ditës

9. Miratimin për transferimin e automjetit “Autoveture e Re Elektrike VW ID4 LFVVB9E66P5006604 me targa AB645PX, nga Agjencia e Shërbimeve Publike Urbane në Agjencinë e Shërbimeve Publike Rurale.

Këshilli Bashkiak me 28 vota pro, 2 kundër, 2 abstenim, miraton sa më sipër.

(E. Murataj; D. Madhi)

(A. Kana; R. Mita)

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.10.2025, ora 12:15 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 10 e rendit të ditës

10. Miratimi i raportit të monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e dytë, të vitit 2025.

Shfaqet Bullari-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Bashkia ka paraqitur një raport të detajuar për 4 mujorin e dytë dhe progresivin si 8 mujor. Ky buxhet është hartuar në mbështetje të ligjit 139/2015 për vetqeverisje vendore, ligjin 9936 për menaxhimin e sistemit buxhetor të Shqipërisë të ndryshuar, të ligjit 68/2017 për financat e qeverisjes vendore. Gjatë periudhës 8 mujore 2025 Bashkia ka menaxhuar burimet e veta dhe ka siguruar të ardhurat e nevojshme për kryerjen e të gjithë funksioneve dhe shërbimeve ndaj qytetarëve. Është lehtësuar sistemi fiskal që ka ndihmuar në zgjerimin dhe zhvillimin e biznesit duke sjellë më shumë të ardhura. Gjithashtu mundësohen edhe shtyerjet e pagesave më pranë taksapaguesve nëpërmjet taksave dhe tarifave të ulta dhe dhënie e lehtësirave fiskale për shtresat dhe familjet në nevojë. Taksa e tokës është në minimumin ligjor çka rezulton e suksesshme në zbutjen e vështirësive ekonomike. Është zgjeruar baza e tatimpaguesve. Të ardhurat si 8 mujor janë realizuar në masën 67% nga 11.06 miliard plani në 7.4 miliard fakti. Në disa zëra analitik fakti të ardhurat është performuar më mirë si taksa e ndërtesës, taksa e truallit, e tabelës, taksa vjetore e mjeteve të përdorura, taksa e zënies së hapsirës publike, tarifa e pastrimit dhe gjelbërimit, e reklamës. Tregues jo të kënaqshëm kanë taksa e ndikimit në infrastrukturë, tatim I thjeshtuar mbi fitimin, të ardhurat nga shërbimi pyjor etj. Fakti I 8 mujorit 2025 është më I madh se 8 mujori I vitit 2024. Shpenzimet buxhetore sipas programit të buxhetit janë realizuar në masën 44

% në raport me planin vjetor 2025 ku paga dhe sigurime janë realizuar në masën 58% të planit vjetor, shpenzimet operative 40% të planit vjetor, transfertat 16% dhe investimet 28%.Theksoj që 4 mujori I dytë ka një rritje të të ardhurave në raport me 4 mujorin e parë rreth 2.5 herë më shumë .Në tabelën analitike të 8 mujorit janë të ardhurat për çdo zë, shpenzimet janë specifikuar sa nga të ardhurat sa nga transfertat e pakushtëzuara, sa nga transfertat e kushtëzuara, sa nga transfertat e pakushtëzuara sektoriale,transferta për investime dhe detyrimet e prapambetura. Për të 9 programet shpenzimet janë paraqitur me detaje në tabela dhe në këtë buxhet 8 mujor Bashkia ka realizuar objektivat e saj për mbulimin e gjithë territorit të Bashkisë me shërbimet publike dhe të nevojshme.Ka përmirësuar infrastrukturën rrugore rurale dhe urbane, shërbimin e pastrimit duke e zgjeruar atë në zonat rurale, ka shtim të sipërfaqeve të gjelbërta, ka përmirësuar infrastrukturën turistike, ka punuar për mbrojtjen e tokave, bujqësore për kullimin dhe ujëtimin e tyre, ka përmirësuar infrastrukturën arsimore, ka siguruar kushte të mira për fëmijë dhe për të rinjtë, ka shtim të aktiviteteve kulturore dhe sportive gjithnjë e më rritje, ka siguruar një mbrojtje civile dhe menaxhim të katastrofave të ndodhura në Bashki. Bashkia për 4 mujorin e fundit ka për detyrë të përmirsojë tregusët financiarë të të ardhurave, shpenzimeve dhe të investimeve si dhe të evidentojë dobësitë si dhe të analizojë me përgjegjësi që të realizohet buxheti I vitit 2025.Shifrat e detajuara I keni në tabelat përkatëse .

Doris Madhi- Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Nga raport monitorimi I këtij 4 mujori vërejmë që kemi një rritje, jo aq të konsiderueshme të pjesa e mbledhjes së taksave.më tepër I referohet atyre taksave që dhe peshën e kanë shumë të ulët në të ardhurat e përgjithshme të buxhetit të Bashkisë por vazhdon ngelet gangrenë pjesa e investimeve.Në fakt për aq sa zen vend totalisht në buxhet investimet që janë vetëm 15% e shpenzimeve vjetore, deri tani që jemi në fund të vitit kemi realizuar vetëm 26% e këtyre.Kjo më rikthen në të njëjtin diskurs që kam bërë prej kohësh.Problemet me investimet I keni për faktin se I mbartni ndër vite.Bëni apo e përdorni buxhetin e Bashkisë si kartë krediti, e harxhojmë sot por e paguajmë pas një viti, pas 2 vjetësh e kështu me rradhë.Prandaj dhe sot ngecni dhe nuk e realizoni dot investimin.Njëherë komplimente se më në fund pashë që të hapet Shkolla Kostandin Kristoforidhi, pas kaq vitesh.Ky është një nga shembujt se pse ju ngecin investimet, bëni planifikime 2 vjeçare dhe nuk I nisni brenda 2 vjeçarit dhe na I risillni parashikim buxhetin

pasardhës. Nuk është normale që të realizohen shpenzime operative maksimalisht, ta ezaurojnë të gjithë pjesën e fondit që kanë. Nuk është normale që të realizohen shpenzimet për pagat, do thoni ju jo se do ua japim pagën punonjësve çdo muaj, po do ja jepni po a e bëjnë punën e vet kto? Pse kto investimet nuk duhen çuar përpara, pse ngecin gjithmonë procedurat e prokurimit, pse 90% e procedurave të prokurimeve të Bashkisë Elbasan janë me flamur të kuq dhe kthehen e rikthehen e përkthehen. Një falenderim tjetër për sallën e këshillit, nuk e di jua kisha bërë apo jo sepse dhe këtu hyn pas 2 vitesh, për sa kohë na thanë rrofshim të gjithë, ishalla po e shfrytëzojmë deri në fund. I bëj thirrje sektorit të prokurimeve publike së Bashkisë Elbasan dhe sektorit të buxhetit që planifikon investimet, të kordinohen mirë në kto zëra sepse kjo gangrena që ju rri këtu nuk do zgjasi vetëm kaq por do të jetë e përhershme. Paratë që mbarten dhe nuk paguhen, kontrata të cilat mbarten dhe nuk nisen. Faleminderit!

Këshilli Bashkiak me 26 vota pro, 6 kundër, 3 abstenim, miraton sa më sipër.

(Y. Balliu; A. Kana; D. Madhi; R. Mita; Z. Muzhaqi; A. Shtylla)

(B. Çopja; M. Kaçuli; N. Meta)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.10.2025, ora 12:15 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 11 e rendit të ditës

11. Miratimi i programit afatmesëm 2026-2028, faza dytë.

Shefqet Bullari-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Programi afatmesëm 2026-2027 çdo vit kalon në 3 faza. Faza e parë është Janar-Qershor kur program bëhet publik dhe i drejtohet Ministrisë së Financave të cilën ne si këshill e kemi miratuar në Korrik dhe faza e dytë është Korrik-Shtator ku është faza teknike për menaxhimin e programit i cili do të miratohet sot. Faza e tretë është Nëntor-Dhjetor ku finalizohet ky me hartimin e buxhetit të vitit 2026 dhe miratohet po në Këshill Bashkiak. Nga treguesit dhe tabelat shohim që të ardhurat sipas zërave dhe burimeve, shpenzimet sipas programeve dhe investimet në shifra janë po ato të miratuara në fazën e parë në Korrik të vitit 2025 pra nuk kemi asnjë ndryshim. Të ardhurat rriten në masën nga 2.5-3 % çdo vit, shpenzimet rriten me 3% ku pagat për personelin mbetën në nivelin që janë por nëse do të ketë rritje do të mbulojë buxheti i shtetit. Shpenzimet për emergjencat civile rriten me 4% të të ardhurave e transfertës së pakushtëzuar çdo vit, fondi rezervë dhe kontigjenca rriten me 5% çdo vit, transfertat e pakushtëzuar rritet çdo vit nga 4.2-4.5% dhe investimet kanë rritjen më të madhe në këtë buxhet që shkon nga 10-12% për çdo vit. Projekti buxhetor afatmesëm përcakton objektivat e bashkisë se si do të shpenzohen të ardhurat, kostot e nevojshme dhe lloji i secilit shërbim. Projekt buxheti afatmesëm synon të garantojë shërbime publike vendore dhe të plotësojë nevojat gjithnjë e më rritje të qytetarëve të Elbasanit. Projekt buxheti afatmesëm përfshin këto procese: E para prezantimi i të ardhurave dhe burimeve të bashkisë, e dyta përcakton vizionin strategjik të bashkisë në ofrimin e shërbimeve, shpërndan

burime sipas fushës dhe ofrimin e shërbimeve, llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve korente dhe investime dhe përcakton treguesit e performancës në çdo fushë të shërbimeve. Pra nuk kemi asnjë ndryshim sa në shifra në raport edhe me atë që kemi miratuar në Korrik. E ftoj këshillin ta miratoj se nuk ka asnjë ndryshim.

Artan Kana-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Nga ajo që pashë dhe lexova është e vërtetë ajo që tha Zoti Bullari që ka rritje për disa pika por meqë jam edhe te komisioni I ndihmës sociale dhe ajo që unë shikova është plani afatmesëm 2026-2028 nuk ka asnjë rritje te mbrojtja sociale. Pavarsisht planeve që ne kaluam tek mbledhja e kaluar për barazinë gjinore, për mbrojtjen sociale, për grupet e marxhinalizuara etj, po kur vjen puna te paratë, paratë janë po ato nuk parashikohet asnjë rritje. Thjesht bëhen letra për të kënaqur shtresa në nevojë që të kemi letrat në rregull për të hyrë në Bashkimin Europian përse I përket mbështetjes së tyre por kur vjen puna te paratë siç e theksova nuk ka rritje. Rritje ka në zërin e pagave dhe të shpenzimeve siç do buxhet që ju keni kaluar këto 2 vjet që unë jam këshilltar. Kjo është diçka që unë jua kam theksuar gjithmonë që është jo produktive për qytetin. Kaloni gjithmonë kur miratoni buxhetet dhe planet për vitin 2026-2028, të jetë fokusi te zhvillimi ekonomik se mesa pashë edhe tek një pikë tjetër këtu që është për mbështetjen e zhvillimit ekonomik shikoj që është zero lekë. Siç jua kam theksuar se vij nga fusha e biznesit nuk mundet që të shtojmë të ardhura dhe mirqënien e këtij qyteti pa zhvilluar ekonomikisht qytetin e Elbasanit që fatkeqsisht është I dyti më I varfër në rang Republike. Mos bëni plane thjesht sa për të plotësuar letrat, të jeni në rregull me ligjin dhe të miratoni buxhete që thjesht kënaqin egot tuaja politike për të ndejtur në pushtet, për të mbajtur një administratë të tejfryrë dhe për të shkuar pjesa më e madhe e buxhetit dhe planeve afatmesme dhe afatgjata thjesht për paga dhe shpenzime. Transferoni më shumë të ardhura në investime dhe mbështetjen e zhvillimit ekonomik të qytetit të Elbasanit. Faleminderit!

Doris Madhi- Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Konstatoj me kënaqësi në këtë rast se kështu duhet me thënë që në 2024 dhe 2025 asnjë person nuk paska humbur jetën në Elbasan ndërkohë që në vend që të jetojnë e të vihen në punë na paska rënë dhe numri I bizneseve aktive nga 6900 në 6176. Çdo shpenzim, çdo investim llogaritet për frymë se dhe buxheti vjen për

frymë.Pse nuk e raportoni numrin e vdekjeve ashtu siç keni raportuar dhe nr e lindjeve.


Këshilli Bashkiak me 27 vota pro,5 kundër, 6 abstenim, miraton sa më sipër.

(A.Kana;D.Madhi;E.Murataj;Z.Muzhaqi;A.Shtylla)

(B.Çopja;A.Domni;E.Isaj;M.Kaçuli;A.Marku;R.Mita)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.10.2025, ora 12:15 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 12 e rendit të ditës

12. Transferim fonde në buxhetin e vitit 2025 dhe periudhën afatmesme 2026-2028.

Shfaqet Bullari-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Nga strukturat e bashkisë është propozuar të bëhen disa ndryshime në buxhetin e vitit 2025 që kanë të bëjnë me një rishikim të shpenzimeve për të mbuluar detyrimet deri në fund të vitit 2025 por dhe me projekte investimesh që duhet të realizohen brenda 2025. Për këtë qëllim një pjesë e projekteve u rishikuan dhe u rikonceptuan nga Drejtoria e Projektimit në përputhje me planin strategjik afatmesëm. Bazuar në kërkesën e drejtorisë së projektimit kërkohet që e para mobilimi i ambjenteve të ndihmës të aktiviteteve sportive dhe grupmoshat e nxënësve të lagjes Qemal Stafa me një vlerë preventivi 3 milion lekë. Vendosi e kondicionerëve dhe arredim në stenda ekspozimi të infopoint dhe muzeut të Shpatit në vlerën 1 milion e 500 mijë, përmirsimi i Bulevardit Aqif Pasha... spo i lexoj më sepse I keni të gjitha tek tabela përkatëse çfarë shtohet dhe pakësimet. Të gjitha janë të mbuluara me fonde përkatëse, duke parë buxhetin që I afrohet vitit, është menduar që një pjesë e investimeve nuk do të bëhen, ka teprica të prokurimeve publike, ka shpenzime të disa drejtorive që nuk arrihen të bëhen dhe të gjitha këto janë kalkuluar dhe është miratuar që të ketë paksim 49 milion e 520 mijë lekë dhe të shtohet në buxhet kjo shumë. Është e nevojshme shpenzimet për energjinë elektrike, për ujin dhe disa shpenzime të tjera të domosdoshme që I keni sipas tabelave që sdua tju vonoj. Gjithmonë në fund të vitit bashkia bën përmbledhjen e saj për mos djegur fondet dhe kërkon nga Këshilli Bashkiak të miratojë, transferimi është I domosdoshëm për vitin 2025.

Gledian Llatja-Kryetar i Bashkisë Elbasan

Në thelb ky është momenti kur mbas ri alokimeve që bëhen tepër buxhetore të investimeve tek të gjitha punët që janë bërë në fakt, duhet të theksoj që ka qenë një vit kryesisht gjatë periudhës së verës që janë përqendruar edhe procedurat e investimeve pasi ka qenë një periudhë një vit zgjedhor siç e dini kishte shumë kufizime përse i përket pjesës së investimeve, investime të bashkisë. Mbasi një pjesë e tyre ka përfunduar dhe disa të tjera të cilat po ri alokohen për tu shtyer në një vit pasardhës. Tepërcat buxhetit të cilët janë menduar që të vihen në funksion të çerdhës 5 të cilat po hapet dhe ne jemi të bindur që mbaron Brenda muajit Janar-Shkurt dhe në buxhetin e vitit tjetër do na vonojë shumë hapja e çerdhës nëse do ta fusnim në buxhetin e vitit tjetër aty kërkohet arredimi. Kemi përfunduar arredimin e çerdhës nr 2 të çerdhës së re. Kemi marrë për bazë një standart të tillë ku është bërë dhe arredimi i çerdhës 5, çerdhës së re që do bëhet, për fëmijët e lagjes Kongresi Elbasanit, Lagjes Aqif Pasha dhe të Rajonit 1 dhe 4 në fakt ku po i shërben edhe më gjërë. Përfundon ndërtimi i saj Brenda muajit Janar dhe pastaj do të vazhdojmë edhe me pjesën e arredimit që duhet bërë gati të jetë funksional. Gjithashtu edhe për Kompleksin Shefqet Lamçja ose sportin e vjetër ku kemi bërë terrenet sportive dhe dhomat e zhveshjes. Është e nevojshme të bëhet dhe arredimi i brendshëm i ktyre pasi nuk ishte parashikuar në fazën e parë por është parashikuar në fazën e dytë. Edhe ato mbarojnë në një kohë relativisht shumë të shkurtër dhe na duhet që dhe ne të bëhemi gati që të mobilojmë dhe të jenë funksionale dhomat e zhveshjes dhe patjetër sipas standarteve më të mira. Gjithashtu kemi menduar dhe diskutuar për një projekt, vitin e kaluar nuk patëm kapacitete financiare për shtimin e ndriçimit në bulevardin kryesor të qytetit ku do të shtohet nga stadium deri afër kalasë. Mbasi kalasë kemi ndriçim sipas standartit që kërkohet ndërkohë që krahu tjetër është bulevardi kryesor i qytetit ka nga një krah dhe do të shtohet edhe nga krahu tjetër pra do të forcohet pjesa e ndriçimit për qytetarët. Ky është një projekt i cili është hartuar në fakt, është i gatshëm dhe pritët vetëm të alokohet fondi për të filluar procedurat e tjera për zbatimin e tij. Kto janë pikat kryesore që është kërkuar rialokimi pastaj janë rialokime të brendshme ashtu siç ka kërkuar sporti për mbështetjen për disa nga sportistët e huaj, klubi shumësportësh për akomodimin e basketbollist dhe volejbollist. Gjithashtu edhe lëvizje të brendshme të buxhetit kryesisht të ardhura nga rialokimet tepërcat që kanë dalë nga prokurimet publike, nga shtimi i një vit i

procedurës për hapjen e rrugëve ke zona përballë me kalanë siç e njohim ne tek zona rreth Gjimnazit Dhaskal Todri. Janë edhe disa investime që nuk realizohen dot këtë vit për arsye të ndryshme kryesisht edhe shpronësimet. Gjithashtu dua të citoj pak edhe pikën 14, edhe ktu është bërë një rialokim tek mbrojtja civile tek zëri I buxhetit që kemi për mbrojtjen civile ku do të investohen në këmbët e urës në Labinot Katund e cila hyn tek pjesa e emergjencave civile dhe është ulur fondi për dëmshpërblimet e banorëve pasi ka patur një kërkesë më të ulët, kishim parashikuar më shumë në fillimin e vitit buxhetor. Pra janë rregullime të brëndshme të buxhetit të cilat në fakt sjellin një efikasitet më të mirë të menaxhimit të fondeve publike. Faleminderit!

Zamir Muzhaqi-Zv. Kryetar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Te artikulli 231 ju e cekët pak por do doja informacion më shumë të lutem. Në fillim të vitit ne si Këshill morëm tek buxheti I vitit 2025, vendosëm tek shpenzimet ndërtimin e disa segmenteve rrugore dhe një prej këtyre është dhe ky I rrugës paralele me bulevardin. Pra artikulli 231 është pakësuar dhe mesa shoh është pakësuar në të 3 vitet

Gledian Llatja-Kryetar i Bashkisë Elbasan

Jo, është thjesht që do të parashikohet vitin tjetër pasi aty ka probleme me pjesën e shpronësimit dhe nuk kanë ecur procedurat e shpronësimit për hapjen e rrugës pasi ka patur edhe interes për zhvillim të zonës për ndërtim, ajo që ne kemi dashur gjithmonë është që për hapjen e rrugëve është që mos shpronësojmë aty ku do hapen rrugët e PDV-së por ligji thotë që në fillim të shprehen banorët për interes pra për zhvillim, kanë interes të zhvillohen në atë zonë dhe të vazhdojnë me zhvillimin e ndërtimit dhe të përkthehet toka e tyre në pjesë të investimit dhe nëse ato nuk pranojnë të vazhdojnë me shpronësimin. Jemi në fazat e para në fakt, nuk kanë ecur procedurat për dakortësinë me banorët për shpronësimin apo zhvillimin e tyre. Dhe ktu ka ngelur, thjesht është shtyrë, me një vit ne e shohim të pamundur ta bëjmë këtë. Projekti është gati që vjet pasi është projekt sipas pdv-së I buxhetuar me detaje të gjitha por ajo që kemi dashur është të mos bëjmë dëme sociale, të futemi me procedura shpronësimi. Ashtu siç e thotë dhe ligji që I jep prioritet ndërtuesit të zhvillojë dhe ne mos e shpronësojmë banorin e banesës por ti japim mundësinë që të zhvillohet ekonomikisht. Në këtë fazë jemi, në fazën 2026-2027 është parashikuar ulja përkatëse dhe do të vazhdojë me të njëjtin ritëm siç ishte pra ishte 2025-2026-

2027 do të vazhdojë e njëjta formulë 2026-2027-2028 për buxhetin afatmesëm të vitit që do miratohet në Dhjetor thjesht është shtyrë me një vit.

Artan Kana-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Dua ta falenderoj Kryetarin e Bashkisë për ezaurimin e asaj që unë kisha si fjalë kur e kërkoja por kam një kërkesë për ty zoti Lala që siç e pe vetë dhe në komision sepse unë shumicën e përgjigjeve që dha kryetari I mora dhe nga Zonja që erdhi na e shpjegoi pikën e transferimeve të fondeve.Kisha një kërkesë që kur vijnë dhe kto miratimi I programit afatmesëm, transferime fondesh që kanë të bëjnë me buxhetin në komisione është e mira të vijnë ekspertët e fushës nga bashkia që për çdo pyetje apo paqartësi që në të jemi më të përgatitur dhe ti kapim pikat siç duhet sepse unë jam për atë që ne jemi për të bërë punë të mira në këtë qytet, nuk jemi për të bërë politikë ktu.Ato që unë them dhe që kam si vërejtje, kam qëllimin e mirë që punët të ecin në këtë qytet sepse unë besoj tek e mira e përgjithshme dhe nëse ajo rregullohet do të rregullohet dhe mirëqënia e kujdo tjetër.Kam dhe një këshillë për kolegët e mi që nëpër komisione duhet të jeni më shumë prezent sepse aty informoheni saktë për atë që do diskutohet në rendin e ditës.Faleminderit!

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

E kanë detyrë për të ardhur por po vazhdon me muaj të tëra që komisionet e këshilleve nuk po funksionojnë siç duhet.Kjo është një kërkesë me vënd dhe antarët e këshillit të ndërgjegjësohen për këtë.

Doris Madhi- Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Në vazhdimësi edhe të fjalës të Këshilltarit Kana që e mbështes.Një dosje finance apo një dosje e cila duhet të përmbajë informacionin e plotë që ne vetëm të marrim vendime për planifikime, për transferime, për shitje apo për blerje, nuk vjen me relacione.Nuk është hera as e parë as e fundit që e kërkoj këtë.E bëj në komision nuk vjen, e bëj në Këshill Bashkiak nuk vjen.Më thoni që kemi një preventiv që përmirsimin e ndriçimit në bulevardin Aqif Pasha është 90 milion lekë të vjetra po ku e keni këtë preventivin?U tremb kryetari,doli ose po ikën tma sjelli.Çfarë janë këto llampa e ndriçime që bëjnë 90 milion lekë ndërkohë që një muze u arredoka me 15 milion lekë të vjetra.Cilat janë zërat e preventivit të çerdhes që janë 165 milion lekë të vjetra?Mirë apo keq secili nga ne ka bërë ndonjë punë të tillë arredimesh nëpër shtëpiat e veta, 165 milion lekë?Pse nuk na e sillni të detajuara

juve këto?Tjetër,I referohem edhe asaj që thashë pak më përpara te monitorimi dhe planifikimi.Flitet prapë për mosrealizimin e investimit në muzeun e Aleksandër Xhuvanit, prapë do e shikojmë neve tek buxheti I vitit pasardhës, viti I 3-të ky.Pse?Sepse keni probleme me procedurat e prokurimeve.Jo nuk keni fare probleme me procedurat e prokurimeve ju, I vetmi problem që keni është ai flamuri I kuq që ju nxjerr APP-ja dhe që nuk ka fatkeqsisht tagrin edhe të marri masa kundrejt jush si autoritet kontraktor.I vetmi problem që keni ju është që nuk arrini të realizoni pazarin ndërmjet atij që do bëjë ofertën dhe atij që do ndajë.Ky është problem që keni ju me investimet.Urime se ju qenkan shtuar shpenzimet e ujit.Na kërkoni 22 milion lekë të vjetra nga ASHPU-ja se na qenkërka rritur çmimi I ujit,po kush e rriti çmimin e ujit?Ky është fiks ai rasti fatkeqsisht I joti ta bën gropën sot.Shpenzimet për ndërlidhsa, kryetar fshatrash, po mirë kur I kaluat këtu në këshill thatë hë se gjëra të vogla janë këto e hajde ta votojmë shpejt.Dashkan dhe lekë të tjera shtesë, pse?Mund të na e argumentoni pak?Pse I duhen 4 milion lekët ktyre ndërlidhsave dhe kryetarët të fshatrave?meqë ra llafi se bëjnë dhe kto pjesë tek aparati juaj I informacionit dhe I përçimit lajmit në kohë reale, përse I përket asaj dëgjësës publike që keni bërë herën e kaluar që kishit vën njoftim për paketën e maleve nuk keni përcaktu fare kalendar, edhe kto ndërlidhsat të paktën ti meritojnë kto lekët, ta përhapin pak lajmin, mos e marrin vesh fshatarët paketën e maleve sot që kemi ardhur neve ktu.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Ato 70-100 mijë lek të vjetra marrin nuk ngeli te ndërlidhsat

Doris Madhi- Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Zoti Lala më duket se kemi bërë herë tjetër këtë debat bashkë dhe të kam thënë edhe 1 lek I vjetër fond publik është fond publik.Edhe me ndërlidhsat do merrem, për aq kohë sa juve të kënaqni çdo patronazhist me lekët e shtetit unë do merrem. Vihet në komision me kto materiale.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Të gjitha I ke edhe në email, jane nga 70-80 faqe Faleminderit, fjala për z.Murataj.

Erjon Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Zoti Lala ndryshe nga kolegja Madhi për mua është lajmi I mirë që kryepërqend dhe ndërlikohet paguhet se bën vakti i gënjen mendja që mund ta bëjnë punën më mirë. Për sa kohë zgjedhja e kryepërqend edhe ndërlikohet bëhen ashtu siç bëre ti në Jagodinë Muriqan, besoj që dal tek fjala e parafolës që janë shpërbleta për patronazhistët megjithatë unë nuk do ndaloja tek ndonjë gjë specifike sesa tek parimi. Dhe kush është parimi, në momentin që ti bën një rialokim fondesh logjikisht ke patur një plan të dëshiruar që në fillim të buxhetit për ta kthyer realitet dhe këtu në ndihmë kush na vjen ne? Buxheti me pjesëmarrje. Pyetja ime është e thjeshtë, ky rialokimi që bëhet në referencë ka ndonjë nga këto kërkesat e buxhetimit me pjesëmarrje, me çfarë pashë unë zero. Që do të thotë të gjithë ata kryepërqend që qofshin me ju, se me ju janë pjesa më e madhe hiq ndonjë, kërkesat I përçojnë ditë për ditë sepse I qan hallin tek dera e shtëpisë për rrugë bie fjala Kryezjarri, bie fjala Funari lart apo Labinotit katund dhe një rialokim fondesh me një pushtet të majtë do të thotë e duhet të përkthet në shërbesë sociale ndaj atyre që patjetër kanë dhënë dhe besimin. Në këtë rialokim fondesh që ju bëni unë shikoj zero reflektim që do të thotë qytetarëve ne duhet tit hemi të vërtetën, rialokimi këtu bëhet për xhepat shpurës të kryetarit dhe gjithë pjesës tjetër drejtues dhe zero interes për hallat e qytetarëve. Dalim te pjesa e faturave që juve ju vijnë si feedback si kjo e rritjes së ujit. Për hir të së vërtetës mua më bëhet shumë qejfi mirëpo ka një problem, në momentin që ti tek kjo pika që po diskutojmë I rrit vetes shpenzimet për ujin mos je pa shpërblim pastaj konviktin se kësaj I thonë na rrëzon poshtë edhe atë shprehjen e famshme që kemi ne të majtët në ato maja rripa rripa, sna del refreni, kaq kisha.

Bianka Çopja- Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Kam thjesht vetëm 1 pyetje duke qenë se dhe kryetari u lodh dhe nuk denjoi të rrinte të paktën në këtë pikë të rëndësishme dhe meqënëse Zoti Asim mund të më japë një përgjigje. Çfarë masash keni marrë për shkeljet që ka evidentuar KLSH-ja, për shkeljet madhore që keni që ndodhin vit pas viti në buxhetin e bashkisë meqë jemi te buxheti? Mund të më jepni një përgjigje të lutem? Nëse nuk mundemi pa problem se e nis me shkrim e më pas ma kthen përgjigjen Zoti Kryetar.

Asim Sula-Zv.Kryetar I Bashkisë Elbasan

Përshëndetje të gjithëve.Në fakt kur flasim për shkelje që ka gjetur KLSH-ja duhet të jemi më specifike për cilat shkelje bëhet fjalë

Bianka Çopja- Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

I keni në raport nuk ka nevojë, ju jeni I vetdijsëm për këto sepse ju vijnë përpara se të fishohen.

Asim Sula-Zv.Kryetar I Bashkisë Elbasan

Sipas raportit që ka bërë KLSH-ja sigurisht që KLSH-ja le sygjerime ose gjëra që duhen përmirsuar ose duhen riparë dhe kto janë gjëra që janë në proces në raport me KLSH-në, në proces zgjidhje.

Bianka Çopja- Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Çfarë masash po merrni ose keni marrë më duhet sepse kto janë shkelje që vazhdojnë vit pas viti, nuk është se pakësohen ose rregullohen, ato thjeshtohen, thjesht masat.Gjithsesi nëse nuk e keni një përgjigje pa problem

Asim Sula-Zv.Kryetar I Bashkisë Elbasan

Kjo është pjesë që e shikon KLSH-ja në raport me njësinë e prokurimit.Janë çështje që ato I zgjidhin në raport me legjislacionin

Bianka Çopja- Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Jo, çfarë po bën bashkia për këtë raport?Nuk po flasim për KLSH-në këtu, jemi për bashkinë

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Ju lutem I lem debatet Zonja Bianka ishte ideja, ti e drejtove pyetjen dhe mund të merrje përgjigjen dhe mos ndërhy më, e lem me kaq.Lidhur me pikën 12 hapet votimi

Këshilli Bashkiak me 26 vota pro, 7 kundër, 3 abstenim, miraton sa më sipër.

(Y.Balliu; A.Kana; D.Madhi; R.Mita; E.Murataj; Z.Muzhaqi; A.Shtylla)

(B.Çopja; E.Isaj; M.Kaçuli)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.10.2025, ora 12:15 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 13 e rendit të ditës

13. Informacion mbi transferimin e asetëve, debitorëve, kreditorëve nga Institucioni i Bashkisë Elbasan në Agjensinë e Mbikqyrjes dhe Kontrollit dhe Agjensinë e Shërbimeve Publike Urbane.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Atë dite te komisioni u diskutua dhe ishte të qartë, nëse ka ndonjë gjë mund ta thoni

Shpëtim Bullari-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Në bazë të vendimit të Këshillit Bashkiak për riorganizimin e njësive operative vartëse, është krijuar Agjensia e Mbikqyrjes dhe kontrollit dhe Agjensia e Shërbimeve Publike Urbane. Deri tani kontabiliteti për kto I mbante bashkia qendër, tani me këtë vendim ne kërkojmë që lista e asetëve e debitorëve dhe e kreditorëve ti kalojë nga Bashkia Elbasan këtyre 2 Institucioneve kryesore që janë Agjensia e Mbikqyrjes dhe Kontrollit dhe Agjensia e Shërbimeve Publike Urbane të cilët do të mbajnë kontabilitet më vete të shkëputur nga bashkia qendër. Bashkangjitur është lista e asetëve, lista e debitorëve, lista e kreditorëve në vite që do të bëjnë pasqyrat financiare të veçanta si njësi vartëse.

Erjon Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Pyetja ime është e thjeshtë, deri tani thamë që ka qenë në bashki, a ka ndonjë raport si ka performuar, pse janë këto debitorët, cilët janë kto kreditorët, dmth ka ndonjë raport pse po bëhet kjo përveç thjesht faktit deçentralizimit dhe kalimit nga brenda mureve të bashkisë tek brenda institucionit në varësi të po të mureve të bashkisë? Ka ndonjë raport si ka performuar struktura e deri tanishme?

Bukurosh Stafa-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Mos dalim nga tema tani, sdo ti hyjmë analizës së bashkisë tani. Ktu është informacion në lidhje me pasurinë, në lidhje me këtë bëj pyetje. Ne diskutojmë për çështjet që janë këtu, nuk do analizojmë të gjithë bashkinë. Bashkinë nëse ke gjë kërkoje, e vendosim te rendi I ditës dhe bëjmë çfarë të duash ti, po jo ktu tani. Vendimarrja ka të bëjë me transferimin e vendimit të qeverisë që jemi të detyruar ta zbatojmë të gjithë, edhe për këtë ka të bëjë vendimi.

Erjon Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Që është I detyrueshëm normalisht shoqërohet me një raport

Bukurosh Stafa-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

E ke relacionin shumë të qartë këtu, nëse nuk do të sqarohesh ti, ti nuk sqarohesh as në një pikë.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Zoti Murataj ke relacionin, mos harxho kohe kot. Hapim votimin.

Këshilli Bashkiak me 27 vota pro, 4 kundër, 5 abstenim, miraton sa më sipër.

(D.Madhi; E.Murataj; Z.Muzhaqi; A.Shtylla)

(Y.Balliu; B.Çopja; E.Isaj; M.Kaçuli; R.Mita)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.10.2025, ora 12:15 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 14 e rendit të ditës

14. Për ndryshimin e vendimit të Këshillit Bashkiak nr 76 datë 01.07.2025 “Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile për vitin 2025”.

Shpëtim Bullari-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Kryetari i Bashkisë bëri një analizë të këtij fakti. Agjensia Kombëtare e Mbrojtjes Civile I ka dhënë bashkisë për vitin 2025 28.405.901 lekë të cilat do të përdoren për kompesimin e banorëve që kanë probleme me djegjet e shtëpive, me tërmete etj dhe pjesa tjetër përdoret për investime, por po të shikojmë për vitin 2025 kemi një problem që fondi për kompesim nuk arrihet për arsye se një pjesë e banorëve janë në zona që nuk është bërë azhurnimi i tokave, nuk marrin dot lejen e ndërtimit për të bërë kompesimin për ndërtimin e shtëpive të cilat mbeten deficitarë dhe për të mos i djegur këto fonde është kërkuar që të kalohen në disa investime që minimizojnë dëmet nga fatkeqësitë natyrore dhe është parashikuar ndërtimi i urës në fshatin Labinot Katund Lagjia Lugaj me vlerë 11.032.014 lekë të cilët do të përballohen 7.196.000 lekë nga kursimet e emergjencave civile dhe pjesa tjetër do të mbulohet nga fondi i emergjencave civile në buxhetin e bashkisë që është 3.835.814 lekë .

Këshilli Bashkiak me 28 vota pro, 2 kundër, 4 abstenim, miraton sa më sipër.

(D.Madhi; E.Murataj)

(Y.Balliu; B.Çopja; E.Isaj; M.Kaçuli)


Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.10.2025, ora 12:15 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 15 e rendit të ditës

15. Për një korrigjim të vendimit nr 112 datë 23.10.2024.

Këshilli Bashkiak me 27 vota pro, 2 kundër, 6 abstenim, miraton sa më sipër.

(D. Madhi; E. Murataj)

(Y. Balliu; B. Çopja; E. Isaj; R. Mita; Z. Muzhaqi; A. Shtylla)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.10.2025, ora 12:15 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 16 e rendit të ditës

16. Marrje me qira (rinovim kontrate) ambjent (strehëz emergjence) për Forumin e Gruas Elbasan.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Kjo përsëritet thuhetse çdo vit, nuk besoj se ka ndonjë vërejtje këtu. Hapim votimin.

Këshilli Bashkiak me 34 vota pro,- kundër, 1 abstenim, miraton sa më sipër.

(D.Madhi)

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.10.2025, ora 12:15 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 17 e rendit të ditës

17. Mbi dhënien në përdorim (pa kundërshtpërblim) të ambjenteve me emërtimin Konvikti “Ymer Tola” (kati i parë dhe kati i dytë) dhe ambjentet e ish Rajonit Nr. 1 Z.K 8521, Akademisë së Futbollit Elbasan nga Bashkia Elbasan.

Erjon Murataj-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Zoti Lala kisha diçka të kjo pika, e para qenka një pikë që e boshatisi sallën nga përfaqësuesit e bashkisë

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Ata kanë secili temat e veta.

Erjon Murataj-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Kjo është gjë e mirë shumë

Përfaqësuesë nga Administrata

Akademia e futbollit të Elbasanit I është drejtuar Bashkisë Elbasan me kërkesë për marrjen në përdorim pa kundërshtpërblim të ambjenteve pjesërisht të konviktit Ymer Tola. Konkretisht bëhet fjalë për katin përdhe ku kanë pas qenë zyrat e ish rajonit nr 1 dhe kati I + kati II me sipërfaqet e përcaktuara dhe në relacion. Ambjentet do të përdoren për akomodimin e të rinjve gjithashtu edhe të stafit shoqëruës gjatë periudhave të stërvitjeve. Bashkia Elbasan mendoi të japë në përdorim këto ambjente duke qenë se pasi janë përdorur për herë të fundit nga administrata e Bashkisë Elbasan nuk kanë patur më një funksion tjetër dhe mendoi të jetë në mbështetje të AFE-së duke qenë se është edhe aksionere me AFE-në për

të mbështetur edhe të rinjtë të cilët duan të merret dhe të zhvillohet aktiviteti sportiv.Është një ndihmesë edhe për të rinjtë të cilët vijnë nga rrethet dhe nuk kanë mundësi akomodimi, gjithashtu edhe nga fshatrat e Elbasanit.Vendimarrja ju takon juve.Faleminderit!

Erjon Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Zoti Lala meqë e nisa fjalën ta përfundoj.E fillojmë me diskutim dhe e mbaroj me një pyetje.Edhe të thashë që është pikë aq e frikshme sa u boshatis salla nga përfaqësuesit e bashkisë.Në fakt AFE-ja duhet falenderuar për rezultatet dhe bashkia në këtë rast duhet që asetet e veta kur I jep pa shpërblim për hotel të na pyesi dhe ne të tjerëve se dhe ne dijmë të bëjmë hotele.Kështu që mund të kishe dhe ofertë madje.Po gjithsesi ajo që shikoj në raport me AF-në nga kjo bashki e pamoral politikisht me çfarë jep dhe merr është që e jep kështu si tek mesazhi asetet e veta.Keni burri juve?Bëni një listë çfarë I duhen atyre e ti japim.Jo unë them që kur ke në plan tja japësh jepja një herë e mirë jo me racion.Duke qenë se kjo pikë lidhet me këtë pikën 3 tek të ndryshmet ku juve arenën kombëtare që e keni marrë nga federata ja kaloni Agjensisë Shërbimeve Publike Rurale, unë kuptoj diçka që keni filluar të bëni atë lojën ta mora ta lashë.Kontratën e kam të qartë,juve kontratën nuk është se e zbatoni shumë.Në rast se kjo do ishte e vërtetë, një dhënie pa shpërblim në të mirë të futbollit të qytetit bësoj që nuk do kishte ndonjë gjë të keqe por ju futbollin e qytetit e keni keqtrajtuar dhe ja keni me hile futbollit të qytetit.Ju si bashki, por meqë të rinj e të reja e futbollistë do duhet që të flenë me logon e AF-së atje, le ta marri AF-ja, po pyetini çfarë I duhet tjetër.Kaq kisha.

Eugen Isaj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Në fakt edhe unë pak a shumë me mendimin e Erjonit jam.Jemi e vetmja bashki që nga ana financiare nuk e kemi mbështetur fare klubin e futbollit.E vetmja bashki.Ka aksione, të gjithë bashkitë e tjera kontribojnë, këshilli bashkiak merr vendimin, kontribojnë jo vetëm për ekipin po edhe për akademinë, për gjithçka.E vetmja bashki jemi ne që deri tani skemi dhënë asgjë.Kështu që në pikën 17 unë jam pro për të rinjtë, për ta kaluar nuk ka asnjë lloj problemi.Problemi qëndron tek ajo që thashë, që I kemi kthyer shpinën sportit në përgjithësi.Faleminderit!

Doris Madhi- Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Meqë po flasim për top, e keni kaluar topin aq herë, e shisni aty e bleni këtu dhe ju kujtoj jo më larg sesa vjet në Shtator shitët aksione me humbje kështu që për mua financiarisht vlen një lloj sikur tja kemi dhënë paradhënie këtë ndihmën AF-së sot. Ne jemi një nga dy bashkitë më të varfra në republikën e Shqipërisë, dhe ne paskemi luksin të japim ambjente pa qera. Kto ambjente nuk janë dhoma një me një veshjeje por është një konvikt i tërë. Mua nuk më duket normale kjo ndihma për aq kohë sa bëhet fjalë për një subjekt sot në formën e Sh.A-së. Mund të ketë atë minimumin e aksioneve të veta bashkia aty brenda por jam edhe shumë e bindur që bashkia e ka tashmë në kapital vlerën e aksioneve që ka kontribuar si kapital fillestar. Kështu që bashkia nuk ka pse të japë ndihma aty ku nuk duhet. Bashkia të shkojë të japë ndihma aty ku duhet, aty ku u fol pak më parë për shtresat e marxhinalizuara. Bashkia të na mbledhi njëherë qentë se jua kam thënë dhe herë tjetër që nuk po hyjmë dot në shtëpi dhe më tepër te qendra e trajtimit të kafshëve paguhen paga sesa trajtohen kafshë. Po tja hedhi një sy edhe pikës 3 bashkia sepse prapë po vitin e kaluar unë që e kam shtëpinë afër qendrës, më nxorret në fshat. Tani po nxirrni edhe Elbasan Arenën në fshat duke kaluar Agjensinë së Shërbimeve Publike Rurale ..nuk po marrim vesh ku po jetojmë më, po na riorganizoni qytetin. Faleminderit!

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Hapim votimin për pikën 17.

Këshilli Bashkiak me 30 vota pro, 3 kundër, 2 abstenim,

Këshilli Bashkiak nuk miraton sa më sipër.

(B.Çopja; R.Mita)

(A.Kana; D.Madhi; Z.Muzhaqi)

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.10.2025, ora 12:15 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Të ndryshme:

3-Mbi shfuqëzimin e Vendimit Nr.79 dt.30.07.2024 dhe kalimin në varësi e administrim të ambjenteve të stadiumit “Elbasan Arena” Agjencise se Sherbimeve Publike Rurale (strukture vartëse e Bashkise Elbasan).

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Kalojmë tek pika e 3-të tek të ndryshmet. Pjesa e bashkisë këtë fjalën rurale dhe urbane mund të na i shpjegojë pak ju lutem.

Përfaqësuese e Administratës

Është Agjensia e Shërbimeve Publike Rurale dhe do ti kalojë në administrim për mirmbajtjen e stadiumit

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Mendoj ta rishikojmë për herën tjetër, pjesa e bashkisë ta rishikoj këtë si problem dhe të na e sjelli herën tjetër.

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.10.2025, ora 12:15 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Të ndryshme:

2- Diskutim mbi kalendarin e konsultimeve publike të buxhetimit me pjesëmarrje 2026.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Unë do të doja te kalendari I buxhetimit me pjesëmarrje, përfaqësuesit e grupeve brenda ditës së premtë të sjellin nga një antar këshilli të cilët duhet të jenë te grafiku I takimeve që do të bëhen plus që kjo nuk pengon asnjë antar të këshillit që duhet të jetë I pranishëm në çdo takim që do bëhet me buxhetimin. Për grafikun teorikisht është siç e shikoni po ne datat do ti vendosim, do të ketë një njoftim 10 ditë përpara se të bëhen takimet. Unë ju pres dhe këto 2 ditë dërgoni te sekretariati një listë me emra siç I keni çdo njësi dhe çdo rajon që duhet të jetë një përfaqësues.

Këshilli Bashkiak me 27 vota pro,- kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.10.2025, ora 12:15 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Të ndryshme:

1- Informacion mbi masat e marra në lidhje me kërkesën e Aleancës së Grave Këshilltare Elbasan.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Lidhur me këtë informacion, Znj. Esmeralda e ka drejtuar?

Esmeralda Mallosi- Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Kërkesa për informacion është dërguar nga aleanca e grave Këshilltare e Bashkisë Elbasan dhe ka të bëjë me nismën që ne kemi ndërmarrë në Tetor 2024 përsa I përket pranimi pa pagesë ose kompensimit të pagesës së çerdheve dhe kopshteve publike për fëmijët e moshës 0-5 vjeç, të grave kryefamiljare me ndihmë ekonomike, të divorcuara si dhe në rastin kur fëmijët e tyre janë PAK. Kemi marrë një përgjigje zyrtare përsa I përket ku jemi me ecurinë e kësaj nisme. Jemi shumë të qartë me përgjigjen tuaj thjesht donim që të fokusoheshim vetëm tek targeti që ne kemi kërkuar dhe jo tek të gjitha këto kategoritë.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Esmeralda kjo çështje është në rrugë e sipër për tu zgjidhur

Esmeralda Mallosi- Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Do tju lutesha që të fokusoheshit dhe ta vinit në zbatim vetëm për këto kategori që ne e kemi bërë nismën. Jo për të gjithë kategoritë që ju jeni duke bërë studimin. Faleminderit!

Artan Kana-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Kisha diçka jo me këto pika por meqë jemi tek të ndryshmet sapo më erdhi dje një ankesë nga një shitës ambulant këtu tek piaca që I kanë shkuar disa zotërinj nga bashkia që I kanë dhënë dhe skicën në dorë dhe I kërkojnë që duhet ta bëjë stendën si shitës ambulant në këtë formë dhe me këto materiale që kërkohen. Ai më pyeti që duhet ti bëjë ai apo do ti bëjë bashkia dhe unë realisht nuk dija çfarë ti thoja, kështu që meqë jemi tek të ndryshmet po e paraqis si kërkesë këtu në këshill që drejtoria përkatëse sepse administrata pothuajse iku që ti japin informacion qytetarit që çfarë duhet të bëjë ai. Do të shkoj tek urbanistika do ti pyes por meqë jemi tek të ndryshmet është e papranueshme që administrata e bashkisë të shkojë tek qytetari shitës ambulant I cili paguan taksën që I ka vendosur bashkia dhe thjesht I le një letër pa I shpjeguar që do e bësh ti apo ai. Dhe unë nuk jam që ta bëjë ai se nuk mund të gjejë atë lloj materiali që kërkon bashkia. Kto janë për bashkinë po do shkoj tek urbanistika dhe do ta ngre.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Faleminderit të gjithëve. Ju uroj punë të mbarë !

Mbledhja përfundon në orën 14:15

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja